

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Të Drejtat Seksuale: është prezantuar një Deklaratë e IPPF mbi instrumentat themelore të të drejtave të njeriut, interpretime serioze të standarteve ndërkombëtare dhe emërtime në lidhje me seksualitetin të cilat IPPF beson se përfshihen në to.

Deklarata është hartuar në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat IPPF aderon. Struktura e Deklaratës është përfshirë gjerësisht në shumë publikime të IPPF dhe të shoqatave anëtare të IPPF. Deklarata i referohet rekomandimeve të traktateve të Kombeve të Bashkuara dhe Reporterëve Speciale të Kombeve të Bashkuara, vecanërisht raportit të vitit 2004 të Standarteve më të larta të Shëndetit. Ky raport u hartua nga një panel ekspertësh përfshirë lidera të njohur në arenën ndërkombëtare në fushën e shkrimit dhe të drejtave riprodhuese. Kjo përmbledhje shërben si një hyrje për sesionet e ndryshme të Deklaratës dhe përmbajtjen e saj. Deklarata e plotë duhet të shoqërojë këtë përmbledhje në mënyrë që të jepen detaje të plota mbi të drejtat seksuale.

Të Drejtat Seksuale: Deklarata e IPPF përmban tre pjesë:

- Një hyrje e cila paraqet konceptin e Deklaratës në kuadër të misionit dhe vizionit të IPPF, marrëveshjet ndërkombëtare dhe dokumentat e lidhura me shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat e njeriut, dhe përcakton objektivin themelor të kuadrit të të drejtave.
- Shtatë principe udhëheqëse të cilat ofrojnë një strukturë të të drejtave seksuale të përfshira në deklaratë dhe do të informojë dhe sigurojnë respektimin, mbrojtjen e përparimin e të drejtave seksuale brenda Federatës. Të drejtat seksuale janë të drejta njerëzore universale dhe të padukshme, dhe janë në përputhje me principet e mos-diskriminimit.
- Pjesa e fundit “ Të drejtat seksuale janë të drejta të njeriut të lidhura me seksualitetin”, përcakton 10 të drejta seksuale. Të drejtat seksuale përbëhen nga një sërë emërtimesh të lidhura me seksualitetin të cilat vijnë nga e drejta për liri, barazi, privacy, autonomi, integritet dhe dinjitet për të gjithë njerëzit.

HYRJE

IPPF është i angazhuar të plotësojë objektivat e tij brenda kuadrit të të drejtave të njeriut i cili përfshin principet e universalitetit, lidhjes, ndërvarësisë, dhe pandashmërisë së të drejtave të njeriut. IPPF njeh dhe beson se të drejtat seksuale janë pjesë përbërëse të të drejtave të njeriut të cilat janë një zhvillim principesh në lidhje me seksualitetin që kontribuon në lirinë, barazinë dhe dinjitetin e njerëzve.

Të drejtat seksuale : Deklaratë e IPPF bazohet në traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe instrumentat të tjerë, në interpretime zyrtare të këtyre standarteve dhe principe shtesë të lidhura me seksualitetin që përfshihet në to.

Bazohet në dokumenta që rrjedhin nga Konferenca e KB mbi të Drejtat e Njeriut 1993; Konferenca Ndërkombëtare e KB mbi Popullsinë dhe Zhvillimin 1994, Konferenca e katërt Botërore e KB mbi Gruan 1995, Deklarata e KB mbi Mijëvjeçarit dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Është e informuar nga rekomandimet e disa trupave të KB dhe Raportimeve Speciale të KB vecanërisht Raporti në Komisionin e të drejtave të njeriut 2004, Raport i Vecantë mbi Standartet më të Larta të Arritshme për Shëndetin.

Deklarata përfshin Çarterin mbi të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese. Synon të identifikojë të drejtat seksuale dhe të mbështesë një vizion përfshirës të seksualitetit. Ky vizion kërkon të respektojë, mbrojë dhe evoluojë të drejtat e të gjithë njerëzve në autonomi seksuale dhe të promovojë shëndet seksual dhe të drejta brenda kuadrit të mos-diskriminimit.

IPPF beson se shëndeti është një e drejtë themelore e domosdoshme për ushtrimin e të gjithë të drejtave të njeriut. Gjithashtu beson se shëndeti seksual dhe riprodhues janë elementë integralë të të drejtave për këdo për të gëzuar standartet më të larta të arritshme të shëndetit fizik dhe mendor. Shëndeti seksual nuk mund të arrihet ose të mbahet pa të drejtat seksuale.

Të drejtat seksuale i referohen normave specifike që rrjedhin kur të drejtat e njeriut aplikohen për seksualitetin. Këto të drejta përfshijnë lirinë, barazinë, privacinë, autonominë, integritetin dhe dinjitetin e të gjithë njerëzve; principe të njohura në shumë instrumenta ndërkombëtare të rëndësishme në vecanti për seksualitetin. Te drejtat seksuale ofrojnë një trajtim që përfshin por shkon përtej mbrojtjes së identiteteve të vecanta. Të drejtat seksuale garantojnë që gjithsecilitë ketë akses në kushtet që lejojnë plotësimin dhe shprehjen e seksualitetit të lirë nga detyrimi me forcë, nga diskriminimi ose dhuna dhe brenda kuadrit të respektimit të plotë të dinjitetit.

IPPF njeh se seksualiteti është një aspekt i rëndësishëm i njeriut në jetë dhe ndërsa ai mund të përfshijë të gjitha dimensionet e mëposhtme, jo të gjitha këto janë të shprehura ose të eksperimentuara. Është një koncept në zhvillim i cili përfshin aktivitetin seksual, identitetet seksuale, orientimin seksual, erotizmin, kënaqësinë, intimitetin dhe riprodhimin. Është formuar nëpërmjet ndërveprimit të faktorëve biologjikë, psikologjikë, socialë, ekonomikë, politikë, kulturorë, etik, ligjorë, historik, fetarë, dhe shpirtërorë. Seksualiteti eksperimentohet dhe shprehet nëpërmjet fantazive, dëshirave, besimeve, qëndrimeve, vlerave, sjelljeve, praktikave, dhe lidhjeve.

IPPF është i vetëdijshëm se shumë shprehje të seksualitetit janë jo riprodhuese dhe se kuptimi mbi seksualitetin po evolon.

IPPF beson se një aspekt kyç për krijimin dhe kushtet për gëzimin e të drejtave bazohet në zhvillimin e strukturave të besueshme. Këto struktura duhet të krijojnë mekanizma fuqie dhe praktike kundra dhunimit të të drejtave seksuale,

IPPF inkurajon shoqatat anëtare të përdorin Deklaratën si një udhërrëfyes për integrimin e angazhimit të tij për respektimin, mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave seksuale në aktivitetet e tij dhe për të forcuar politikën, strategjitë dhe programet.

IPPF është i angazhuar për një vizion të drejtave njerëzore universale, të pandashme, përfshirë të drejtat seksuale. Njeh gjithashtu se konteksti lokal mund të influencojë kohën, mënyrat dhe zgjerimin e zbatimit të principeve dhe të drejtave përfshirë në këtë Deklaratë.

Deklarata u ratifikua nga **Këshilli Drejtues i IPPF-it** më 10 Maj 2008.

Duke theksuar rolin e vecantive kombëtare dhe rajonale dhe diversitetin historik, kulturor dhe fetar, organizatat dhe individët të cilët punojnë në të gjitha rajonet e botës mund të

përfshijnë kuadrin dhe principet e Deklaratës në aktivitetet, shërbimet dhe programet e tyre. Kjo do të ndihmojë në promovimin, mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave seksuale. Te bindur se ky kuadër në shëndetin seksual dhe riprodhues do të promovojë realizimin e të drejtave seksuale si një aspekt i drejtësisë botërore, i zhvillimit dhe i shëndetit ne paraqesim principet që vijojnë:

Principi 1 *Seksualiteti është pjesë integrale e personalitetit të cdo qenieje njerëzore, për këtë arsye duhet të krijohet një ambjent i favorshëm në të cilin cdokush mund të gëzojë të drejtat seksuale si pjesë e procesit të zhvillimit*

Seksualiteti është pjesë përbërëse e personalitetit të cdo qenieje njerëzore në të gjitha shoqëritë. Ndërsa individët përjetojnë seksualitetin në një mënyrë e cila ndryshon nga faktore të brendshëm dhe të jashtëm, të drejtat e njeriut të lidhura me seksualitetin, mbrojtja dhe promovimi i tyre duhet të jenë pjesë e ekzistencës së përgjithëshme të të gjithë individëve. Seksualiteti duhet të njihet si një aspekt pozitiv i jetës. Të drejtat seksuale janë të drejta njerëzore universale të bazuara në liri, dinjitet dhe barazi për të gjithë qëniet njerëzore.

Në përputhje me Çarterin mbi të drejtat seksuale dhe riprodhuese, IPPF afirmon se njeriu është subjekti kryesor i zhvillimit dhe njeh rëndësinë e krijimit të një ambjenti të favorshëm, në të cilin cdo individ mund të gëzojë të gjitha të drejtat seksuale që të jetë i aftë të marrë pjesë aktivisht në proceset ekonomike, sociale, kulturore dhe në zhvillimin politik. Seksualiteti është një aspekt i jetës sociale dhe njerëzore i cili angazhon gjithmonë trupin, mendjen, politikën, shëndetin dhe shoqërinë.

Principi 2 *Të drejtat dhe mbrojtjet e garantuara për njerëzit nën 18 vjec ndryshojnë nga ato të të rriturve, dhe duhet të merren parasysh zhvillimin e aftësve të fëmijës për të ushtruar vetë të drejtat e tij.*

IPPF njeh se të drejtat dhe mbrojtjet që garantohen për njerëzit që janë nën 18 vjec , në kuadër të ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare , nganjëherë ndryshojnë nga të drejtat e të rriturve. Këto ndryshime lidhen me të gjitha aspektet e të drejtave të njeriut por kërkojnë trajtim të veçantë për të drejtat seksuale. IPPF nis nga fakti që personat nën 18 vjeç janë titullarë të drejtash, dhe se në pika të ndryshme brenda spektrit të femijërisë, dhe adoleshencës disa të drejta dhe mbrojtje kanë rëndësi më të madhe ose më të vogël.

Në lidhje me këtë, principi i zhvillimit të kapaciteteve kombinon respektin për fëmijët, për dinjitetin e tyre dhe mbrojtjes nga cdo formë e dëmit, duke njohur vlerën e kontributit të tyre për mbrojtjen. Shoqëritë duhet të krijojnë ambjent në të cilin fëmijët mund të arrijnë kapacitetet optimale dhe kur i jepet respekt më i madh atyre për të marrë përgjegjësi dhe për të marrë vendime për jetën e tyre.

Principi 3 *Mos – diskriminimi thekson mbrojtje për të drejtat e njeriut dhe promovim të tyre.*

IPPF njeh se një kuadër ligjor i mos diskriminimit thekson mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Ky kuadër ndalon cdo **dallim**, perjashtim apo kufizim me bazë seksin, moshën, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, statusin martesor, historinë seksuale ose sjelljen seksuale, ose me bazë racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, fenë,

pikëpamjet politike ose opinione të tjera, origjinën kombëtare ose sociale, pronën, lindjen, paaftësinë fizike ose mendore, gjendjen shëndetësore përfshirë HIV/ SIDA, statusin civil, politik social ose status tjetër i cili ka për qëllim mosnjohjen, mosgëzimin, mos ushtrimin në mënyrë të barabërtë me të tjerët të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër. Individët përjetojnë barriera të ndryshme në përmbushjen e të drejtave të tyre seksuale. Barazia kërkon të hiqen këto barriera me qëllim që individë të ndryshëm të gëzojnë të drejta dhe liri themelore, të barabarta me të tjerët. Kjo kërkon që vëmendje e vecantë ti kushtohet grupeve të marxhinalizuara dhe në nevojë.

Principi 4 Seksualiteti, dhe kënaqësia që vjen nga ai, janë një aspekt themelor i të qenit njeri, nëse një person zgjedh ose jo të riprodhohet.

Seksualiteti është një faktor integruar në të gjitha vendimet mbi riprodhimin; megjithatë është një aspekt thelbësor i të qenit njeri, nëse vendos ose jo të riprodhohesh. Seksualiteti nuk është një mjet për të kënaqur interesat riprodhuese. Perjetimi dhe gëzimi i seksualitetit pavarësisht nga riprodhimi, duhet të mbrohet, duke i kushtuar vëmendje të vecantë zgjidhjes së çështjes nëse kjo i është mohuar në të kaluarën dhe në të tashmen.

Principi 5 Garantimi i të drejtave seksuale për të gjithë përfshin një angazhim për liri dhe mbrojtje nga dëmi.

E drejta për tu mbrojtur nga çdo formë e dhunës dhe dëmit.

Dëmi i lidhur me seksualitetin përfshin dhunën dhe abuzimin fizik, verbal, psikologjik, ekonomik, dhe seksual sikurse dhunën kundra njerëzve për shkak të seksit, moshës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, statusit martesor, historisë ose sjelljes seksuale, praktikave seksuale ose si ato e manifestojnë seksualitetin e tyre.

Të gjithë fëmijët dhe adoleshentët kanë të drejtë të gëzojnë të drejtën për mbrojtje nga të gjitha format e shfrytëzimit. Kjo përfshin mbrojtjen nga shfrytëzimi seksual, prostitucioni i fëmijëve dhe të gjitha format e abuzimit seksual, dhuna dhe ngacmimi, përfshirë mbrojtjen kundra detyrimit të fëmijës të angazhohet në ndonjë aktivitet ose praktikë seksuale dhe të përdoren për shfaqje dhe materiale pornografike.

Principi 6 Të drejtat seksuale janë subjekt kufizimesh të vedosura me ligj me qëllim sigurimin dhe njohjen dhe respektin e të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe në përgjithësi për mirëqënien në një shoqëri demokratike.

Të drejtat seksuale janë subjekt kufizimesh të vedosura me ligj me qëllim sigurimin dhe njohjen dhe respektin e të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe në përgjithësi për mirëqënien në një shoqëri demokratike, të shëndetit publik dhe të rregullit publik, në përputhje me ligjet e të drejtave të njeriut. Keto kufizime mund të jenë jo diskriminuese të domosdoshme për arritjen e një misioni të ligjshëm. Ushtrimi i të drejtave seksuale duhet të udhëhiqet nga ndërgjegjësimi i lidhjes dinamike midis interesave personale dhe të shoqërisë, njohja e ekzistencës së shumë vizioneve, dhe nevojës për të garantuar barazi, dinjitet dhe respekt për ndryshim.

Principi 7 Detyrimi për respekt dhe mbrojtje aplikohet në të gjitha të drejtat dhe liritë.

Të drejtat dhe liritë seksuale përfshijnë kërkesa ligjore sikurse akses në mjete për ti përmbushur këto kërkesa. Ashtu si me të drejta të tjera njerëzore shtetet kane detyrime ne tre nivele: të respektojnë, të mbrojnë dhe të plotësojnë të drejtat seksuale të të gjithëve.

TË DREJTAT SEKSUALE JANE TË DREJTA NJERËZORE TË LIDHURA ME SEKSUALITETIN

IPPF pohon se të drejtat seksuale janë të drejta njerëzore. Të drejtat seksuale përbëhen nga një numër emërtime të lidhura me seksualitetin të cilat rrjedhin nga e drejta për liri, barazi, privacy, autonomi, integritet dhe dinjitet për të gjithë. 10 të drejtat seksuale janë:

Neni 1: E drejta për barazi, mbrojtje të barabartë para ligjit dhe te jemi te lire nga të gjitha format e diskriminimit të bazuar në seks, seksualitet apo gjini.

- Të gjithë njerëzit kanë lindur të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta dhe duhet të gëzojnë mbrojtjen të barabartë nga ligji kundra diskriminimit bazuar në seksualitetin e tyre , seksin ose gjininë.
- Të gjithë personave duhet tu sigurohet një ambjent ku cdokush gëzon dhe ka akses të barabartë për të drejta të plota të mbështetura nga shteti. Shtetet dhe shoqëria civile duhet të ndërmarrin hapa për të promovuar modifikimin e praktikave sociale dhe kulturore të bazuara në role stereotipe të grave ose burrave ose mbi idenë e superioritetit ose inferioritetit të sekseve, gjinive ose shprehjes së interesit.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të punojnë, shkollohen, te gezojne shëndetin, sigurinë sociale dhe të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore sikurse mjete, te mira, shërbime dhe kushte të nevojshme për ti realizuar ato, pa diskriminim në cdo fushe.
- Të gjithë njerëzve duhet t’iu jepen afëksi ligjore dhe mundësi të njëjta për të ushtruar këto aftësi, të drejta të barabarta për të hyrë në kontakt dhe për të administruar sic duhet, dhe do të trajtohet në mënyrë të barabartë në të gjitha fazat e procedurës në gjykata, duke konsideruar zhvillimin e kapacitetit të fëmijës.
- Të gjithë personat do të kenë të njëjtat të drejta në lidhje me ligjin qe lidhet me lëvizjen e personave dhe lirinë për të zgjedhur rezidencen dhe shtëpinë, pa diskriminim.

Neni 2: E drejta për pjesëmarrje për të gjithë personat, pavarësisht nga seksi, seksualiteti ose gjinia

- Të gjithë personat kanë një ambjent i cili mundëson pjesëmarrje aktive, të lirë dhe kuptimplotë në aspektet civile, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të jetës në nivele lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare nëpërmjet të cilave të drejtat e njeriut dhe liritë themelore mund të realizohen.
- Të gjithë personat kanë të drejtën të marrin pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave që përcaktojnë mirëqënien e tyre, përfshirë shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues, pa barriera formale ose informale si martesë, kualifikimet, kushtet e lidhura me statusin e HIV, ose normat gjinore diskriminuese, stereotipet dhe paragjykimet që përjashtojnë ose kufizojnë pjesëmarrjen e personave bazuar në idetë për gender dhe prirjen seksuale.
- Të rinjtë, të cilët shpesh përjashtohen, do të kenë të drejtën të jenë pjesëmarrës dhe protagonistë në proceset e ndryshimit në shoqëritë e tyre. Ata do të kenë mënyra për të kontribuar dhe do të ndajnë përgjegjësitë për zhvilluar politika dhe programe për të mbrojtur, promovuar dhe përmbushur shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese.
- Të gjithë personat do të jenë në gjendje për të marrë pjesë në jetën publike dhe politike, përfshirë mbajtjen e pozicioneve publike dhe për të ushtruar funksione publike, pa diskriminim në çdo fushë.
- Si bazë për pjesëmarrjen, të gjithë personat do të gëzojnë të drejtën për të lëvizur dhe për të larguar dhe për të kthyer në vendin e tyre të origjinës sikurse akses të barabartë në dokumentacion që siguron këtë lëvizje dhe udhëtim pa diskriminim.

Neni 3: E drejta për jetën, lirinë, sigurinë e personit dhe integritetin fizik.

- Të gjithë personat kanë të drejtën për jetën, lirinë dhe të mos torturohen, të mos trajtohen me mizori, në mënyrë johumane dhe degraduese, dhe kanë të drejtë të ushtrojnë seksualitetin e tyre pa dhunë dhe detyrim me forcë.
- Të gjithë personat kanë të drejtë për jetën dhe integritetin fizik. Këto të drejta nuk duhet të kërcënohen osë të vihen në rrezik “për shkak të nderit” të familjes.
- Asnjë person nuk duhet të jetë subjekt i vrasjeve të gjyqimit ose jashtë gjyqimit, ndëshkimi, për shkak të historisë së tij ose sjelljes së tij seksuale, identitetit gjinor ose shprehjes.
- Asnjë jetë gruaje ose shëndeti i tyre nuk duhet të vendosen në rrezik si pasojë e trajtimit mjekësor të mohuar për ndonjë kusht mendor ose fizik, ose bazuar në faktin që është shtatzënë.
- Asnjë grua nuk do të ndëshkohet në një shtatzëni me forcë për shkak të ushtrimit të seksualitetit të saj.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të jenë të lirë nga praktika tradicionale, përfshirë mutilacionin gjenital femëror dhe martesë në moshë të vogël me forcë.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të jenë të lirë nga dhuna, përfshirë të gjitha format e abuzimit fizik, verbal, psikologjik ose ekonomik, ngacmim seksual ose dhune seksuale, përdhunim, dhe ndonjë formë tjetër marrëdhëniesh seksuale me forcë brenda ose jashtë martesës, në konflikte të armatosura, në burg.
- Të gjithë personat, përfshirë punonjëset e seksit të të gjitha gjinive ose në kushtë të një aktiviteti seksual jashtë martesë, kanë të drejtën të jenë të lira nga rreziku i

dhunës të krijuar nga stigma dhe diskriminimi bazuar në seksin e , seksualiteti ose gjininë e tyre.

- Asnjë zgjedhje seksuale e njeriut, praktike ose shprehje, përfshirë praktika reale të punës seksuale, mund të justifikojnë ose ulin ndëshkimin për dhunën, abuzimin ose ngacmimin.
- Të gjithë emigrantët dhe punonjësit migrantë, vecanërisht të rinjtë, femrat e reja dhe emigrantet transeksualet, duhet të kenë akses, në vendet ku ata punojnë dhe jetojnë, në mjetet e mbrojtjes nga dëmi trupor nga dhuna dhe abuzimi bazuar në shprehjen e tyre seksuale dhe gjinore, sikurse mjetet për të mbrojtur dhe plotësuar shëndetin dhe të drejtat e tyre seksuale.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të kërkojnë dhe të gëzojnë azil nga persekutimi, përfshirë persekutimin që lind si nga veprimi i Shtetit ose mos marrja e hapave të rëndësishme për të mbrojtur personin nga abuzimi serioz, në bazë të seksit, gjinisë, identitetit gjinor, historisë seksuale ose sjelljes seksuale ose statusit të Hiv-it.
- Të gjithë personat duhet të jenë të lirë nga heqja, ekstradimi ose dëbimi nga ndonjë Shtet ku mund të përballen me frikën e persekutimit bazuar në seks, gjini, identitet seksual, historinë seksuale ose sjelljen ose orientimin seksual ose statusin eHIVit.

Neni 4: E drejta per privacy

- Të gjithë personat kanë të drejtë të mos i nënshtrohen ndërhyrjeve arbitrare në jetën e tyre private, familje, shtëpi, letra ose korrespondencë dhe kanë të drejtë për privaci, e drejtë e cila është thelbësore për ushtrimin e autonomisë seksuale.
- Të gjithë personat gëzojnë autonomi seksuale dhe do të jenë në gjendje të marrin vendime rreth seksualitetit të tyre, sjelljeve seksuale dhe intimitetin pa ndërhyrje arbitrare.
- Të gjithë personat kanë të drejtë për konfidencialitet në lidhje me shërbimet dhe kujdesin për shëndetin seksual, dosjet mjeksore dhe në përgjithësi për mbrojtjen e informacionit në lidhje me statusin e Hiv dhe të mbrohen nga veprimet arbitrare ose kërcënimet e veprimeve arbitrare, brenda kuadrit të kufizimeve të lejueshme dhe pa diskriminim.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të kontrollojnë shpërndarjen e informacionit në lidhje me zgjedhjet seksuale, historinë seksuale, partnerët seksualë dhe sjelljet seksuale dhe çështje të tjera të lidhura me seksualitetin.

Neni 5: E drejta për autonomi personale dhe njohje para ligjit

- Të gjithë personat kanë të drejtë të njihen para ligjit dhe të gëzojnë liri seksuale, e cila përfshin mundësinë për individët të kontrollojnë dhe të vendosin lirisht mbi çështjet që lidhen me seksualitetin, të zgjedhin partnerin e tyre seksual, të kërkojnë të eksperimentojnë potencialin e tyre të plotë seksual dhe kënaqësinë, brenda kuadrit të mos diskriminimit dhe duke konsideruar të drejtat e të tjerëve dhe zhvillimin e aftësive të fëmijëve.

- Të gjithë personat kanë të drejtë të njihen kudo si person para ligjit, pa diskriminim në asnjë fushë.

Të gjithë janë të lirë të ushtrojnë praktika seksuale të lidhura dhe autonome, dhe të kryejnë brenda një ambjenti me kushte sociale, politike dhe ekonomike në të cilat të drejtat dhe liritë mund të realizohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë, pa diskriminim, pa dhunë dhe detyrim me forcë ose abuzim.

Asnjë person nuk duhet të jetë subjekt i ligjeve të cilat në mënyrë arbitrare kriminalizojnë lidhjet seksuale konsensuale ose praktikat seksuale, as të jenë subjekt arrestimi ose burgosjeje në bazë të seksit, seksualitetit apo gjinisë, apo praktikave seksuale ose sjelljes seksuale.

Të gjithë personat që janë në ruajtje kanë të drejtë të mos përballen me abuzim ose rrezik nga dëmi në bazë të ndonjë çështjeje diskriminimi. Të gjithë personat në ruajtje kanë të drejtë të mbrohen nga marxhinalizimi dhe të kenë vizita të rregullta nga bashkëshortët.

- Të gjithë personat duhet të gëzojnë të drejtën të jenë të lirë nga dëmet e lidhura me krimin e trafikimit.
- Asnjë person nuk duhet të jetë subjekt i kërkimeve mjeksore jovullnetare ose procedurash, ose të detyrohen me forcë të bëjnë teste mjeksore ose mjekime arbitare e të jenë të mbrojtur kur shprehin seksualitetin e tyre; orientimin seksual; historinë seksuale; ose sjelljen, identitetin gjinor real ose të fituar.
- Asnjë person nuk duhet të detyrohet të kalojë procedura mjeksore, përfshirë kirurgji për seksin, sterilizim ose terapi hormonale si kërkesë për njohje ligjore të identitetit gjinor të tyre ose të jenë subjekt të presionit për të mbetur shtatzënë, të shtypen ose t'i mohohet seksi, mosha, gjinia, identiteti gjinor ose orientimi seksual.
- Asnjë personi nuk duhet t'i mohohet karta e identitetit e cila tregon gjininë e tij/saj ose seksin si reflektim i identitetit personal të njeriut, përfshirë por jo i kufizuar nga certifikatat e lindjes, pasaportat dhe regjistrimet elektorale.

Neni 6: E drejta për liri mendimi , opinionit dhe shprehjeje, e drejta për tu mbledhur

- të gjithë personat kanë të drejtë të ushtrojnë lirinë e mendimit, opinionit dhe shprehjes pavarësisht nga idetë mbi seksualitetin, orientimin seksual, identitetin gjinor dhe të drejtat seksuale, pa ndërhyrje arbitrare ose kufizime bazuar në besime kulturore ose ideologji politike ose nocione diskriminuese të rregullit publik, moralit publik, shëndetit publik ose sigurisë publike.
- Të gjithë personat kanë të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, përfshirë të drejtën për të mbajtur opinionet pa ndërhyrje, brenda kuadrit të mosdiskriminimit dhe respektit të zhvillimit të kapaciteteve të fëmijëve.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të eksplorojnë seksualitetin e tyre, të kenë endrra dhe fantazi të lirë nga frika, turpi, faji, besime fallco dhe pengesa të tjera të shprehjes së lirë të dëshirës, me kujdes të vecantë të të drejtave të të tjerëve.

- Të gjithë personat, vecanërisht gratë , kanë të drejtën e shprehjes së identitetit ose karakterit nëpërmjet fjalimeve, veshjeve, karakteristikave trupore, zgjedhjes së emrit dhe mënyrash të tjera kufizimi.
- Të gjithë personat kanë lirinë të kërkojnë, të marrin dhe shpërndajnë informacion dhe ide në lidhje me të drejtat e njeriut, të drejtat seksuale, nëpërmjet ndonjë mënyrë ligjore dhe pa kufizime, brenda një kuadri jodiskriminues dhe duke marrë në konsideratë të drejtat e të tjerëve dhe zhvillimin e kapaciteteve të fëmijëve.
- Të gjithë njerëzit kanë të drejtën e lirisë së mbledhjes së lirë dhe bashkimit në forma të ndryshme. Kjo përfshin të drejtën për të themeluar , bashkuar dhe krijuar grupe dhe organizata dhe për tu zhvilluar, për të shkëmbyer , shpërndarë informacion për të bërë fushata dhe për të lancuar ide për çështje të lidhura me të drejtat e njeriut, të drejtat seksuale, seksualitetin, orientimin seksual, identitetin gjinor nëpërmjet një mjete brenda kuadrit të rregullit social në të cilin të drejtat dhe liritë mund të realizohen plotësisht.

Neni 7: E drejta për shëndet dhe për të përfituar nga progresi shkencor

- Të gjithë personat kanë të drejtë të gëzojnë standartet më të larta të arritshme të shëndetit mendor dhe fizik, i cili përfshin prioritetet e shëndetit dhe aksesin në kujdes shëndetit seksual për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e të gjitha shqetësimeve seksuale, problemeve dhe crregullimeve.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të insistojnë në seks të sigurtë për parandalimin e shtatzënive të padëshiruara dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme përfshirë HIV dhe SIDA.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të marrin pjesë në vendosjen e ligjit, politikave, programeve dhe shërbimeve që i përkasin shëndetit publik në komunitetet e tyre. Të gjitha ndërhyrjet e shëndetit duhet të jenë të ndjeshme ndaj nevojave të vecanta të individëve të marxhinalizuar dhe komuniteteve.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të kenë akses në informacion rreth të drejtave seksuale, orientimit seksual, seksualitetit dhe identitetit gjinor në lidhje me shëndetin dhe të kenë akses në shërbimet më të mira shëndetësore dhe në kërkime të vlefshme.
- Të gjithë personat përfshirë punonjëset e seksit kanë të drejtë në kushte pune të sigurta, akses në shërbime shëndetësore, dhe mbrojtje dhe mbështetje për të qenë në gjendje të insistojnë në praktika seksuale të sigurta me të gjithë partnerët dhe klientët.
- Të gjithë personat në konflikte të armatosura ose të shpërngulur me forcë duhet të kenë akses në shërbime të plota të shëndetit seksual dhe riprodhues.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të gëzojnë benefitet e progresit shkencor dhe aplikimet e tij në shëndetin seksual dhe të drejtat seksuale.
- Të gjithë njerëzit duhet të kenë të drejtë dhe mjete të kenë akses ose të refuzojnë teknologjinë e shëndetit riprodhues, shërbimet ose ndërhyrjet mjeksore në baza ta barabarta me të tjerët pa diskriminim. Kufizimet me baze moshen duhet t'u përgjigjen kërkesave të mos diskriminimit dhe principit të zhvillimit të aftësive të fëmijës.

- Të gjithë njerëzit duhet të kenë të drejtën dhe mjetet të kenë akses ose të refuzojnë pjesëmarrjen në kërkime shkencore mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim.

Neni 8: E drejta per edukim dhe informim

- të gjithë njerëzit, pa diskriminim, kanë të drejtë për tu edukuar dhe informuar në përgjithësi në lidhje me edukimin seksual dhe informimin e nevojshëm dhe të dobishëm për të ushtruar qytetarinë dhe barazinë në fushen publike, private dhe politike.
- Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të edukohen për të çrrenjosur stigmën dhe diskriminimin, për të promovuar zhvillimin e të rinjve si aktorë në marrjen e përgjegjësisë për jetën e tyre dhe për t'i fuqizuar për të marrë pjesë në vendosjen e politikave në lidhje me shëndetin seksual dhe edukaten seksuale.
- Të gjithë njerëzit dhe në vecanti të rinjtë kanë të drejtë të japin input për programet e edukimit seksual dhe politikat që lidhen me seksualitetin.
- Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të kenë mjete të zhvillojnë aftësitë për të negociuar lidhje më të forta dhe më të barabarta.
- Të gjithë njerëzit pavarësisht nga kufijtë kombëtarë duhet të kenë akses në informacion tradicional dhe jotradicional për të theksuar seksualitetin, të drejtat seksuale dhe shëndetin seksual; të rinjtë duhet të kenë akses në informacion mbi jetën seksuale dhe gjininë dhe lidhjet seksuale.
- Të gjithë personat do të kenë akses në shërbime komunitare, shkolle dhe mjekësore dhe informacion në lidhje me seksualitetin në një gjuhë të kuptueshme, përfshirë informacionin mbi mjetet për të siguruar shëndet seksual dhe rirrodhues dhe vendim marrje se kur, si dhe me kë të kenë marrëdhënie seksuale dhe kur sjellja seksuale do të bëhet rirrodhuese.
- Të gjithë njerëzit kanë të drejtë për edukim të mjaftueshëm dhe informacion për të siguruar që cdo vendim që ata marrin në lidhje me seksualitetin e tyre dhe jetën rirrodhuese ta marrin të plote dhe të lirë dhe joformal.
-

Neni 9: E drejta për të përdorim ose jo të martohesh dhe për të formuar dhe për të planifikuar një familje, dhe të vendosin nëse jo dhe kur të kenë fëmijë.

- Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin nëse duan të martohen ose jo, nëse duan të krijojnë familje ose jo, kur të kenë fëmijë dhe kohën kur të kenë fëmijë në menyre të lirë dhe të përgjegjshme, brenda ambjentit në të cilin ligjet dhe politikat njohin diversitetin e formave të familjeve sikurse përfshijnë familjet e papërcaktuara nga trashëgimia ose martesë.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të hyjnë lirisht dhe me miratim të plotë në martesë ose në lidhje partenriteti të cilat janë të vlefshme pa diskriminim dhe duke marrë në konsideratë zhvillimin e aftësive të fëmijëve.
- Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të mirëqënies sociale në lidhje me familjen dhe benefite të tjera publike si ato të lidhura me punësimin dhe emigrimin, pavarësisht nga forma e familjes që ata kanë zgjedhur të formojnë, përfshirë ato të pa përcaktuara nga trashëgimia ose martesë.

- Të gjithë personat kanë të drejtë të kenë akses në informacion, edukim dhe mjete që ju nevoiten për të qenë në gjendje të vendosin lirisht dhe me përgjegjësi për numrin dhe kohën kur t'i lindin fëmijët.
- Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të bëjnë zgjedhje të lira dhe të përgjegjshme në lidhje me riprodhimin dhe formimin e familjes, përfshirë të drejtën për të vendosur nëse të kenë fëmijë biologjikë apo të adoptuar, sikurse metoda të rregullimit të fertilitetit të sigurt, efektive, të pranueshme, teknologji riprodhuese dhe trajtime.
- Të gjithë njerëzit kanë të drejtën e keshillimit dhe shërbime të tjera të në lidhje me riprodhimin, infertilitetin dhe ndërprerjen e shtatzënisë, pavarësisht nga statusi civil, dhe brenda kuadrit të mosdiskriminimit dhe marrjes në konsideratë të zhvillimit të aftësive të fëmijëve.
- Të gjitha gratë kanë të drejtë të marrin informacion, edukim dhe shërbime të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit riprodhues, mëmësisë së sigurtë dhe abortin e sigurt, të cilët të jenë të disponueshme, të arritshme, të pranueshme dhe me leverdi për të gjithë përdoruesit.
- Të gjithë njerëzit do të kenë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi në lidhje me ruajtjen, besimin dhe adoptimin e fëmijëve, ose institucione të ngjashme ku këto koncepte ekzistojnë në legjislacionin kombëtar, brenda kuadrit të mosdiskriminimit; në të gjitha rastet interesi më i mirë i fëmijëve janë me shumë rëndësi.

Neni 10: E drejta për kredibilitet

- Të gjithë njerëzit kanë të drejtë për masa efektive, të disponueshme edukative, ligjore juridike dhe të tjera për të siguruar për të ushtruar të drejtat seksuale. Kjo përfshin aftësinë për të monitoruar dhe zbatuar të drejtat seksuale dhe për të pasur akses në zgjidhje në rastet e dhunimit të të drejtave seksuale, përfshirë aksesin nëpërmjet kthimit, kompensimit, rehabilitimit, garantimit të mos përsëritjes së dhunës.
- Shtetet duhet të krijojnë mekanizma besueshmërie për të siguruar që detyrimet e shteteve të përmbushen që të garantojnë të respektohen të drejtat seksuale.
- Të gjithë njerëzit duhet të kenë akses në mekanizma efektive për kredibilitet gjatë konflikteve të armatosura, veçanërisht në lidhje me dhunën me baze gjinore dhe seksuale.
- Të gjithë njerëzit duhet të kenë akses në informacion dhe asistencën e nevojshme për të qenë në gjendje të kërkojnë zgjidhje në rastet e dhunimit të të drejtave seksuale.
- Të gjithë personat kanë të drejtë të marrin në konsideratë aktorët jo shtetërorë veprimet e të cilëve ose mosveprimet ushtrojnë impakt në gezimin e të drejtave seksuale. Kjo përfshin aftësinë për të kërkuar zgjidhje për çdo dhunim të të drejtave seksuale.
- Shtetet duhet të marrin hapa për të parandaluar që të tretët të dhunojnë të drejtat seksuale të të tjerëve.

IPPF është i angazhuar të bëjë gjithcka për t'i përmbushur këto, përfshirë dhënien e asistencës teknike, asistencës financiare, krijimit të kapaciteteve, për të inkurajuar Shoqatat Anëtare të bëjnë avokati për të drejtat seksuale, të ofrojnë shërbime të shëndetit seksual jo diskriminuese dhe të orientuara nga klientet, informacion, edukate seksuale dhe të aftësojnë stafin e tyre nëpërmjet programeve dhe projekteve në përputhje me Principet dhe Te Drejtat Seksuale të inkuorporuar në këtë Deklaratë.

REFERENCA DHE SHWNIME

Burimet e pwrdorura pwrfshtijnw instrumenta tw tw drejtave tw njeriut dhe interpretime zyrtare tw standarteve ndwrkombwtare, ligje dhe politika tw qeverive dhe avokati dhe procese tw ndwrmarra nga Shoqatat Anwtare tw IPPF-it.

- Teksti i plotw i Çarterit tw IPPF mbi tw Drejtat Seksuale dhe Rirpodhuese 1995 mund tw gjendet tek:
www.ippf.org/en/Resources/Statements/IPPF+Charter+on+Sexual+and+Reproductive+Rights.htm
- Teksti i plotw i shumw standarteve dhe raporteve ndwrkombwtare tw strukturave tw Kombeve tw Bashkuara pwr tw drejtat e njeriut mund tw gjenden nw web sitin e Komisionerit tw Lartw tw tw Drejtave tw Njeriut tw Kombeve tw Bashkuara :
www.ohchr.org
- Per diskutimin e plow tw shwndetit seksual dhe tw drejtave seksuale nga OBSH shiko: www.who.int/reproductive-health/gender/sexualhealth.htm=4
- Teksti i plotw i Principeve tw kartws Yogy : Principe mbi aplikimin e Ligjeve Ndwrkombwtare tw tw Drejtave tw Njeriut pwr orientimin seksual dhe identitetin gjinor.mund tw gjenden tek: www.yogykartaprinciples.org
-